



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1406, datë 23.09.2010

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1345, datë 23.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrative të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativë, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.09. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications, në lidhje me Aktin Administrativë të Keshillit Drejtues të AKEP, **Vendimi nr.1345**, datë 23.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 te AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”,

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);

2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918
4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (**Rregullorja**).
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
6. **Vendim i KD nr. 1345**, datë 23.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 1921/6 prot, datë 25.08.2010 e AMC sh.a (AKEP nr. 1421/7 prot, datë 25.08.2010) “Ankimi Administrativ ndaj vendimit nr.1345 datë 23.07.2010 të KD te AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, (**Ankim Administrativë**);
2. Vendim nr.1345, date 23.07.2010 të AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, (**Vendimi**);
3. Projektvendim i KD te AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrative të Albanian Mobile Communications sh.a, në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr.1345, date 23.07.2010 të AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Projektvendimi**);
4. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
si dhe,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AMC brënda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 140 të ligjit nr.8485, ka bërë ankimi administrativ për ndryshimin e pjesës dhe/ose shfuqizimin/revokimin e Aktit Administrativ Vendimi nr. 1345, datë 23.07.2010 të AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.
2. AMC sh.a me shkresën nr. 1921/6 prot, datë 25.08.2010 (AKEP nr. 1421/7 prot, datë 25.08.2010) “Ankimi Administrativ ndaj vendimit nr.1345 datë 23.07.2010 të KD të AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, kërkon ndryshimin e pikës 1 të vendimit lidhur me asimetrinë e tarifave të terminimit të aplikueshme ndaj operatorit Eagle Mobile sh.a duke e ulur tarifën e terminimit në rrjetin e operatorit Eagle Mobile deri në masën që lejon një asimetri të shkallës 13% që perputhet me rekomandimet e ERG dhe kufizimin kohor të kësaj mase deri në fund të vitit 2010.
 - AMC thekson se i qëndron pozicionit të saj të mëparshëm të cilin e ka shprehur edhe në ankimin e mëparshëm administrative, Asimetria e tarifave të terminimit ndaj operatorit Eagle Mobile sh.a duhet të ulur deri në masën 13% në perputhje me rekomandimet e ERG.
 - Reduktimi i tarifës së terminimit të operatorit Eagle Mobile sh.a nga 13.32 leke/min në 12.20 leke/min që i korrespondon një niveli të asimetrie prej rreth 16% është ende më e lartë se niveli i asimetrisë të vendeve të BE-së;
 - Vendosja e një tarife të terminimit për Eagle Mobile 12.20 lek/min i korrespondon një niveli asimetrie me të lartë në masën 16%, duke e favorizuar Eagle Mobile kundrejt AMC

AMC sh.a këte kërkesë të saj e mbështet në përfundimet e metodologjisë BULRAIC dhe tendencës për ulje të asimetrisë;
3. Ankimi administrativ në lidhje me VKD nr.1345, datë 23.07.2010, pezullon efektet e tij, nga data e depozitimit të ankimit në AKEP deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të AKEP mbi ankimin administrativ;
4. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrative, në lidhje me asimetrinë e tarifës së terminimit midis AMC dhe Eagle Mobile gjykon se:
 - a. Me VKD nr.1346, datë 23.07.2010, AKEP ka pranuar kërkesën e EM: *Tarifa maksimale e terminimit të thirrjeve në rrjetin e Eagle Mobile të përcaktuar në nenin 4.4.2 të Vendimit 1212 datë 31.03.2010 të ndryshohet duke respektuar një asimetri ndaj tarifave të VFAL dhe AMC të barabartë me 23%, duke vendosur midis të tjerave:*

Tarifa maksimale e terminimit të thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile, të jetë të jetë 12.92 lek/minute dhe tarife 0.39 lek/per thirrje.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

- b. Niveli dhe rritja e asimetrise eshte gjykuar e arsyeshme per kushtet e tregut Shqiptar te komunikimeve elektronike ne telefonine celulare.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 1921/6 prot, datë 25.08.2010 të AMC per reduktimin e asimetrise se tarifave te terminimit midis Eagle Mobile dhe AMC;
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**